



Fletinformacion për vizitat e mbrojtësve

Ky fletinformacion përshkruan në formë të përmbledhur procedurën për organizimin e vizitave të mbrojtësve me të paraburgosurit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('OP') që gjendet në burgun holandez PI Haaglanden, në Sheveningen ('burgu').

Informacion i përgjithshëm

Mbrojtësve dhe bashkëmbrojtësve të të paraburgosurve u miratohen vizita të rregullta. Anëtarët e ekipit të mbrojtjes të cilët janë të miratuar në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit mund të shoqërojnë mbrojtësin ose bashkëmbrojtësin gjatë vizitës me të paraburgosurin.

Vizitat e mbrojtësve janë të privileguara. Ato kryhen brenda rrezes së shikimit, por jo brenda rrezes së dëgjimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të oficerëve të paraburgimit.

Vizitat dhe komunikimet e mbrojtësve rregullohen me [Rregulloren e Paraburgimit](#) dhe me udhëzuesit e punës dhe udhëzimet përkatëse, ndër të cilat:

- [Vizitat dhe komunikimet e mbrojtësve](#);
- [Udhëzimi për vizitat përmes videolidhjes](#);
- [Rregullorja e brendshme](#);
- [Kushtet e sigurisë për hyrje në objektin e paraburgimit](#); dhe
- [Sendet dhe substancat e ndaluara në objektin e paraburgimit](#).

Organizimi i vizitave

Kontakti

Pyetjet në lidhje me procedurën e organizimit të vizitave mund t'ia drejtoni zyrës së administrimit të Njësisë së Paraburgimit ('zyra e administrimit') në adresën elektronike visitors-DMU@scp-ks.org.

Planifikimi i vizitave personale të mbrojtësve

Orari dhe kohëzgjatja e vizitës së mbrojtësit planifikohen paraprakisht në marrëveshje me shefin e paraburgimit. Vizita e mbrojtësit mund të planifikohet përmes zyrës së administrimit. Gjatë planifikimit të vizitës personale, mbrojtësi duhet të informojë paraprakisht zyrën e administrimit në qoftë se në vizitë do të ketë të pranishëm edhe anëtarë të tjerë të ekipit të tij, numrin e anëtarëve të pranishëm dhe emrat e tyre. Në mënyrë që kërkesa për vizitë të mundësohet dhe konfirmohet pa vonesë, mbrojtësi kontakton zyrën e administrimit lidhur me kërkesën për vizitë jo më vonë se një ditë para saj, jo më vonë se 16:30.

Vizitat përmes videolidhjes

Gjithashtu mund të organizohen vizita përmes videolidhjes për t'iu ofruar të paraburgosurve një mundësi shtesë për të komunikuar me mbrojtësit e tyre. Procedura e organizimit të vizitave të



mbrojtësve përmes videolidhjes është e ngjashme me procedurën për organizimin e vizitave personale, sikurse përshkruhet më lart.

Ditët dhe orari i vizitave

Vizitat e mbrojtësve mund të kryhen midis orës 9:00 dhe 16:45 nga e hëna në të premte.

Në qoftë se për shkak të orarit të seancave gjyqësore në Dhomat Specializuara, një i paraburgosur nuk mund të takojë mbrojtësin e vet gjatë orarit të rregullt të vizitave për përgatitjen e mbrojtjes, në raste të veçanta shefi i paraburgimit mund të autorizojë vizitë jashtë këtij orari dhe ajo organizohet sipas kushteve të posaçme.

Ndihma në marrjen e vizës shengen

Disa mbrojtësve mund t'ju duhet vizë shengen për hyrje në Holandë. Pyetjet në lidhje me procedurën e marrjes së vizës dhe hyrjes në Holandë mund t'i dërgohen shefit të Zyrës së Mbrojtjes si personi i kontaktit për të gjithë mbrojtësit, në adresën elektronike: defencecoordination@scp-ks.org.

Kushtet e hyrjes

Kontrollet e sigurisë

Për të hyrë në burg dhe në objektin e paraburgimit, mbrojtësi dhe anëtarët e ekipit të tij duhet t'u përmbahen kushteve të sigurisë. Në përgjithësi, çdo person që kërkon të hyjë në objektin e paraburgimit duhet:

- të paraqesë dokument të vlefshëm identiteti, si për shembull pasaportën ose letërnjoftimin e shtetit përkatës;
- të japë pëlqimin për t'u kontrolluar; dhe
- t'u përmbahet masave përkatëse në lidhje me sigurinë.

Procedurat dhe kontrollet e sigurisë kryhen duke respektuar konfidencialitetin e materialeve të përfshira në konfidencialitetin e komunikimit mbrojtës-klient. Informacion më të hollësishëm në lidhje me masat përkatëse të sigurisë do të gjeni në udhëzimin për [Kushtet e Sigurisë për Hyrje në Objektin e Paraburgimit](#).

Sendet dhe substancat e ndaluara

Mbrojtësit nuk lejohen të sjellin sende ose substanca të ndaluara në burg dhe në objektin e paraburgimit, përfshirë telefonat mobilë dhe pajisjet USB (p.sh., kartela për memorie të bartshme (*flash drives*)). Listën e plotë do ta gjeni në [Sendet dhe Substancat e Ndalura në Objektin e Paraburgimit](#).

Materiale të nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes

Të paraburgosurit dhe mbrojtësit mund të sjellin në burg dhe në objektin e paraburgimit disa materiale për përgatitjen e mbrojtjes, sikurse përcaktohet në rregullën 26 të Rregullores së Paraburgimit.

Gjatë vizitave, mbrojtësit zakonisht mund të sjellin kompjuterët e tyre të bartshëm (laptop) dhe të shkëmbejnë dokumente fizike drejtpërsëdrejti me të paraburgosurit.



Në qoftë se dëshiron të sjellë materiale në format digjital për të paraburgosurin ('sjellje') ose të marrë materiale në format digjital nga i paraburgosuri ('nxjerrje') për nevojat e përgatitjes së mbrojtjes, mbrojtësi duhet të ndjekë procedurën e paraparë për shkëmbimin e materialeve të përcaktuar në [Rregulloren e Brendshme](#). Materialet regjistrohen dhe respektohet konfidencialiteti i komunikimit mbrojtës-klient. Në këtë mënyrë mund të sillen edhe CD ose DVD të zbrazëta, me kusht që paraprakisht të regjistrohen. Për ta pasur më të qartë, mbrojtësit do t'i jepet një listë e materialeve në formë digjitale sjellja ose nxjerrja e të cilëve lejohet.

**Ky dokument është vetëm një përmbledhje informacioni në vija të përgjithshme dhe nuk përbën dokument ligjor. Për një pasqyrë të plotë të rregullave në lidhje me vizitat e mbrojtësve, mbrojtësit këshillohen të lexojnë Rregulloren e Paraburgimit dhe udhëzuesit e punës dhe udhëzimet përkatëse (www.scp-ks.org).*